

PROCES VERBAL
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ANETAREVE TE SHOQATES
« CHAMBRE DE COMMERCE ET INDUSTRIE FRANCE-ALBANIE »
ME 29 PRILL 2021 NE OREN 15:00

MIRESEARCHDJA :

Pas verifikimit, te kryer nga Notere Lorena Shkjezi Karafili se anetareve te shoqates te pranishem « *online* », me qellim sigurimin e nje quorum-I te mjaftueshme qe Asambleja e Pergjithshme te jete e vlefshme dhe te mblidhet, vazhdohet me:

Drejtori Ekzekutiv jep disa informacione teknike mbi organizimin e takimit: perkthim simultan, specialist i IT i pranishem gjate mbledhjes per ndihme teknike sipas nevojehes si edhe procesi i votimit do te ndiqet ne prani te noterit, online

- ❖ Noteri deklaron qe kuorumi eshte arritur dhe se 38 anetarë janë të pranishëm ose të përfaqësuar, online si edhe informon mbi procesin e votimit në internet, me votim të fshehtë

FJALA PERSHENDETESE (e Kryetarit, bashkangjitur)

Julien ROCHE pershendet pjesemarrësit dhe **hap zyrtarisht Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme**. Ai informon se 38 anetare jane te pranishem, kuorumi eshte arritur e mund te merren vendime.

Ai u uron te gjithëve nje bashkepunim te frytshem!

- ❖ Fjala pershendetese e SHS Ambasadores se Francës ne SHqiperi, Zj. Elisabeth Barsacq
- ❖ Kryetari i shoqates Z. Roche vazhdoi me rendin e dites se Asamblese se Pergjithshme, duke filluar pika 4 e rendit te dites e me pas kalimi ne votim te hapur.

Rendi i dites se Asamblese se Pergjithshme

1. Regjistrimi: Identifikimi nga notarja - Disa informacione teknike- Blerina Kazhani
2. Fjala e Kryetarit
3. SHS Ambasadorja e Francës në Shqipëri, Zj. Elisabeth Barsacq
4. Vendim për të shtyrë mandatin e anëtarëve të KD në fuqi për një periudhë prej 12 muajsh
5. Bilanci i aktiviteteve 2020 e strategjia e CCI për vitin 2021-2022
6. Raporti moral dhe financiar 2020
7. Prezantimi I kandidatëve
8. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Administrues 2021-2023 (*votim i fshehtë online*)

9. Pyetje të ndryshme

Bilanci i aktiviteteve 2020 e strategjia e CCI për vitin 2021-2022 te shoqates nga Drejtore Ekzekutive Zj. Blerina Kazhani;

Raporti Financiar I Z. Teit Gjini, pergjegjes i thesarit te shoqates.

Pika 4.diskutohet , votohet me 34 vota pro, 0 kunder, 0 abstenim ;

Asambleja e Pergjithshme miraton me unanimitet :

***Piken 4 te rendit te dites
Bilanci i aktiviteteve 2020 e strategjia e CCI për vitin 2021-2022
Raporti moral dhe financiar 2020***

PREZANTIMI I KANDIDATEVE :

Presidenti fton kandidatët të garojnë për postet e tyre përkatëse dhe informon anëtarët se është bërë një gabim në statut.

Para se kandidatët të prezantohen, Ai u propozon anëtarëve të votojnë modifikimin e statuteve e nenet perkatese si me poshte:

- Një president, tre Zëvendës Presidentë dhe pese Administratorë, nga të cilët një Administrator eshte edhe & Përgjegjës i Financës

Neni 15 : *Menaxhimi i veprimtarive të CCIFA i është besuar Këshillit të Administrimit, pa shpërblim, i cili përbëhet nga anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, jo më pak se 7, por jo më shumë se 9.*

Neni 16 : *Kandidatët për postin e 1 (një) - Presidenti, 3 (tre) - Zevendës Presidentëve, 5 (pese) - Administratorëve, një nga të cilët Administrator & Përgjegjës i Financës, i propozohen për votë Asamblesë së Përgjithshme.*

Neni 18: *Në rast vakance për arsye të dorëheqjes, vdekjes ose shkaqe të tjera, Këshilli i Administrimit duhet të shtojë përkohësisht një administrator të ri sipas listës së zgjedhjeve të mëparshme për të arritur numrin minimal prej 7 anëtarësh deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.*

NENI 19 : *Për çdo dy vite financiare, Asambleja e Përgjithshme zgjedh (me votim të fshehtë): Një president, tre Zëvendës Presidentë dhe pese Administratorë, nga të cilët një Administrator eshte edhe & Përgjegjës i Financës.*

Anëtarët miratojme me unanimiet propozimin e presidentit për ndryshimin e statuteve e nenet perkatese : Një president, tre Zëvendës Presidentë dhe pese Administratorë, nga të cilët një Administrator eshte edhe & Përgjegjës i Financës

- ❖ Presidenti Roche fton kandidatet te prezantohen

President :

- 1) Julien Roche

Zv. -presidente

- 1) Zgjim Mita/Automita
- 2) Jean Alain Jouan/Aleat - Groupe IDEMIA (mungon, perfaqesohet nga Znj. Blerina Kazhani)
- 3) Patrick Pascal/Selenice Bitumi

Përgjegjës i Financës

- 1) Diana Ylli/Mazars

Administrator:

- 1) Florian Hasko/Tashko Pustina
- 2) Eni Kalo/Kalo&Associates
- 3) Odhise Zoto/ACTI shpk
- 4) Gjergji Themeli/Albinfos

- ❖ Perpara fillimit te votimit , rikonfirmohet numri i anetareve te pranishem. Pas votimit te ndryshimeve ne statut dhe perpara fillimit te votimit per piken e katert te rendit te dites, online, jane larguar kater anetare te shoqates, duke bere qe numri i pjesemarrësve ne votim per zgjedhjen e Kryetarit,Zv. Kryetari i Pare, 3 Zv. Kryetar, 1 Pergjegjes Thesari dhe 4 anetare te Keshillit drejtues, jane 34 anetare votues.
- ❖ Me tej vijohet me prezantimin nga Noteria te fletes se votimit te fshehte, online, duke shpjeguar rastet e pavlefshmerise se votes.
- ❖ Anetaret vijojne me votimin duke u regjistruar sipas numrit perkates, ne menyre te verifikimit edhe nje here te pjesemarrjes se tyre ne votim. Ky verifikim behet nga Noteria Lorena Shkjezi Karafili.
- ❖ Procesi i votimit perfundon ne oren 16.10 ;

❖ REZULTATI I ZGJEDHJEVE :

- Në fund të procesit të votimit, Noterja Lorena Shkjezi Karafili e ndihmuar nga specialisti i IT Ervin Kurti dhe Drejtori Ekzekutiv Blerina Kazhani verifikuan votat
- Gjate numerimit rezultuan 34 flete votimi te vlefshme;

- ❖ Ne perfundim te numerimit **rezultuan te zgjedhur** :

Kryetar :	Julien Roche	33 vota
Pergjegjes i Thesarit	Diana Ylli	34 vota
Zv. Kryetare	Zgjim Mita	28 vota
	Patrick Paskal	25 vota
	Jean Alain Jouan	26 vota

Anetare te Keshillit Drejtues	Odhise Zoto	25 vota
	Eni Kalo	29 vota
	Gjergji Thelemi	23 vota
	Florian Hasko	28 vota

- ❖ Pas perfundimit te numerimit Noteria Lorena Shkjezi Karafili ben njoftimin e rezultatit perfundimtar te votimit , duke permendur te gjithë fituesit si dhe numrin e votave qe ka marre secili prej tyre.
- ❖ Ne kete menyre Asambleja e Pergjithshme e Anetareve me shumice votash si me siper Miraton te gjitha popozimet e ndryshimeve ne statut si edhe zgjedh Presidentin, Pergjegjesin e Thesarit, 3 Zv. Presidentet si dhe 4 Anetare te Keshillit Drejtues.
- ❖ Zgjedhjet deklarohen te rregullta dhe miratohen nga Notere Zj. Lorena Shkjezi Karafili
- ❖ Asambleja e Pergjithshme deklarohet e mbyllur ne oren 16.23 te dates 29.04.2021
- ❖ Procesverbali mbahet nga zj. Sekretare e Asamblese Zj. Blerina Kazhani, drejtore ekzekutive e shoqates « Chambre de Commerce et Industrie France –Albanie ».
- ❖ Proces-verbalit i bashkelidhet kopje e listeprezences se anetareve te pranishem ne Asamblene e Pergjithshme te dates 29.04.2021.
- ❖ Procesverbali nenshkruset pa verejtje edhe nga Noteria Lorena Shkjezi Karafili, duke patur per qellim vertetimin e korrektesise ne mbajtjen e tij si dhe vertetesine e listeprezences se anetareve.

MBYLLJA E ASAMBLESE NGA JULIEN ROCHE

« Deklaroj te mbylluar mbledhjen e Asamblese se Përgjithshme. Uroj te gjithë te Zgjedhurit dhe ju falenderoj te gjithëve për punën tuaj të përditshme dhe gjithashtu për pjesëmarrjen në këtë Asamble.

Shihemi së shpejti. Faleminderit të gjithëve! »

Kryetar i Asamblese

Julien Roche

Sekretar I Asamblese

Blerina Kazhani

Notere

Lorena Shkjezi Karafili

